



## ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01- Nr-016-54309

Më datë 12.09.2024

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 20/2016” e konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës Nr.400-524/1 të datës 22.08.2024 të MAPL-së Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Koordinues për zbatimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2023-2025” në këtë përbërje si më poshtë:

- 1.1 Avni BYTYÇI-----Zyra Ligjore-----kryesues
- 1.2 Ardita KOLGECI-----Qendra për shërbime me qytetaret-----anëtare
- 1.3 Çlirim GEGAJ-----Zyra për teknologji informative-----anëtar
- 1.4 Kujtime ALIAJ-----Zyra për komunikim me publikun-----anëtare
- 1.5 Eurolinda ZENELAJ-----Përfaqësuese e shoqërisë civile-----anëtare

2. Komiteti koordinues ka për obligim që në bashkëpunim me përfaqësuesit e MAPL-së, ti përmbushin zotimet dhe obligimet që dalin nga “Plani Kombëtar i Veprimit për Qeverisje të Hapur për periudhën 2023-2025”.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe e shfuqizon vendimin me nuemr 01-Nr-410-53914 të datës 11.09.2024.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;

MAPL-ja

Anëtarët e komitetit

Arkiva